

UDHËZIM
Nr. 19, datë 31.8.2023

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 10, DATË 30.3.2020, “PËR
PËRCAKTIMIN E ELEMENTEVE PËRBËRËSE, FORMËN E DIPLOMËS OSE
CERTIFIKATËS SË LËSHUAR NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË DHE
PROCEDURËS SË REGJISTRIMIT TË TYRE NË REGJISTRIN SHTETËROR TË
DIPLOMAVE DHE CERTIFIKATAVE PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN
SHKENCOR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të neneve 10 dhe 91 të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 10, datë 30.3.2020, “Për përcaktimin e elementeve përbërëse, formën e diplomës ose certifikatës së lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në Regjistrin Shtetëror të Diplomave dhe Certifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si më poshtë:

a) Shkronja “gj” e pikës 1, të kreut II, të riformulohet si më poshtë:

“gj) Emri dhe mbiemri i rektorit dhe i drejtuesit të njësisë kryesore që plotësohen me shtypshkrim dhe nënshkrimi i rektorit dhe i drejtuesit të njësisë kryesore që plotësohen me shkrim dore. Në rastin e një Kolegji Profesional të Lartë ose kur organizohet si njësi kryesore pranë një LAL-je vendoset emri dhe mbiemri i rektorit dhe i drejtuesit të njësisë bazë që plotësohen me shtypshkrim dhe nënshkrimi i rektorit dhe i drejtuesit të njësisë bazë që plotësohen me shkrim dore.”.

2. Ngarkohet për zbatim të këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi